



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA PËRMBARIMORE "SPAHIU" SH.P.K.



Nr. 437 Regj., Nr. 1306/3 Prot.



Tiranë, më 16/09/2022

URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar: Qendra Kombëtare e Biznesit, (QKB) Tiranë
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë

Për dijëni: Debitorit, Subjekti Xhaferr Ferhat Gaçi, ID Nr.G40326217T
Adresa: Rruga "Hamid Shijaku", Nr.13, Njësia Adm. 9, ish stacioni trenit, Tiranë

Kreditorit, Zija Ferik Demiri, i datëlindjes datë 20.04.1961
Adresa: Rruga "Myslim Keta", Pallati 14, Shk.1, Ap.16, Tiranë

Objekti: Kthim shume

Unë, Eqerem Spahiu, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore "SPAHIU" sh.p.k. me numër NIPT: L62204027C, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.5521, datë 30.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.437, kërkesën e kreditorit Zija Ferik Demiri ndaj debitorit, subjekti Xhaferr Ferhat Gaçi në lidhje me Titullin Ekzekutiv, Kontratë Huaje Nr.3645 Rep, Nr.119 Kol, datë 26.08.2011 & Kontratë Zevëndësimi Nr. Rep. 2059. Nr. Kol. 509/1, datë 26.08.2014.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr.2238/2 Prot, datë 11.05.2022, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit,

KONSTATOVA se :

Debitori, Xhaferr Ferhat Gaçi, është vënë më dijëni për njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit, Xhaferr Ferhat Gaçi në masën, që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të neneve 36 pika (e), 37 pikat (b;c) dhe 53 të Ligjit Nr.26/2019, "Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat".

URDHËROJ

Vendosjen e masës së sekuestros konservative, mbi aksionet e zotëruara nga:

Subjekti "MERGA" sh.p.k. me Nipt: K26513469M, në masën 47% të kapitalit të zotëruar nga pala debitore Xhaferr Gaçi.

Adresa: Dibër, Martanesh Krastë.

1. Të njoftohem dhe informohem menjëherë në lidhje me procedurën e vënies së sekuestros nga ana juaj, në lidhje me:
 - a) Adresën e ushtrimit të aktivitetit.
 - b) Llojin e aktivitetit për të cilën është paisur me licence.
 - c) Bllokimi e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimi të aktivitetit.
2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
4. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

ZYRA PËRMBARIMORE "SPAHIU" SH.P.K

Përmbartues GJYQËSOR

Eqerem SPAHIU

